



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË
DEPARTAMENTI GJEODEZI – BSc.

2015 – 2019

2.3. Programi i studimit në vlerësim: GJEODEZI

2.3.1. Të dhënat themelore për programin e studimit

Emri i programit të studimit	Gjeodezi
Niveli i studimit sipas KKK (me shkurtesat BA, MA, PhD, program doktrate, kurs universitar, certifikatë apo diplomë profesionale)	Niveli 6 BA
Grada akademike dhe emërtimi i diplomës në formë të plotë dhe të shkurtër	Bachelor i Gjeodezisë- Departamenti i Gjeodezisë Bsc i Gjeodezisë
Fusha e studimit sipas <i>Erasmus Subject Area Codes (ESAC)</i>	07.6
Profili i programit akademik (specializimi)	Gjeodezi
Kohëzgjatja minimale e studimit	Minimum 3 vite studimi
Forma e studimit (e rregullt, pa shkëputje nga puna, studim në distancë, etj.)	I rregullt
Numri i ECTS kredive (total dhe për vit)	180 ECTS , 60 ECTS , në vit
Modulet/ lëndët (titujt)	Obligative: Sem. I 1. Algjeber Lin. dhe Gjeo.analitike 2. Programimi 3. Fizikë duke përfshirë mekanikën 4. Teknologjia e bazës së të dhënave 5. Gjuhe e Huaj 6. Ekologji Sem. II 1. Gjeometri llogaritese 2. Analize matematikore 3. Matje e tokës 4. Bazat e gjeoinformatikës Sem. III 1. Bazat e gjeodezisë 2. Kadastri 3. Bazat e gjeodezise inxhinierike 4. Metodot e barazimeve Sem. IV

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Gjeometria diferenciale 2. Fotogrametri 3. Hartografi 4. Matje në terren, praktikë me instrumente gjeodezike <p>Sem. V</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pozicionim satelitor 2. Hulumtimet nga largesite 3. Rrjetat gjeodezike 4. Aplikimi i GIS-it <p>Sem. VI</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullimi i tokës 2. Menaxhimi i tokës 3. Punim Diplome <p>Zgjedhore:</p> <p>Sem. II</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Aplikimi i CAD-it në gjeodezi 2. Bazat e gjeoteknikës <p>Sem. III</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hartografia Topografike 2. Regjistrimi dhe vlerësimi i patundshmërive <p>Sem. IV</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Planifikimi Hapësinor 2. Menaxhimi i ujërave 3. Studimi i fizibilitetit për GIS <p>Sem. V</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sistemi i Informimit të Tokës 2. Ligji 3. Aplikimi i GNSS-it në pozicionim dhe navigim <p>Sem. VI</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Menaxhim 2. Etika profesionale 3. Web hartografia
Numri i vendeve të studimit	50 studentë
Udhëheqës i drejtimit/ programit të studimit	Prof.ass.dr. Përparim Ahmeti
Personeli i përhershëm shkencor/ artistik (numri sipas kategorive)	11 mesimdhenes dhe 10 asistent
Taksa e studimit	Sipas tarifave të UP-së

2.3.2. Arsyeshmeria e programit për tregun e punës

Trendet e zhvillimit në sektorin e gjeodezisë në vendin tonë janë pikën më të lartë të aktiviteteve duke krahasuar me periudhën 10 - 20 vjeçare nga vitet e kaluara. Kërkesat gjithnjë e më të shtuara për matje të ndryshme gjeodezike nëpër zona urbane dhe rurale

te Kosovës. Hartimet e projekteve zhvillimore Urbane të qyteteve tregojnë nevojën e madhe të rritjes së kërkesave për matje. Gjithashtu edhe ekonomia në sektorin privat në vend jep indekse pozitive të rritjes dhe kërkesa është permanente për miratime të zonave ekonomike. Vendi ynë me stadin shumë të vogël të zhvillimit të të gjitha sektorëve, krijon gjithmonë hapësira për investime të mëdha të subjekteve nga më të ndryshëm. Konfiguracioni i Kosovës, pasuritë e saj, karshi relacionit të popullatës kanë potencial gjithmonë të mjaftueshme për investime kapitale në shumë sektorë sikur do të mundën të përmenden: industria, transporti, turizmi, ekonomia e vogël – sektori individual etj. Krejt këto aspekte që u përmenden me sipër, mund të konvertohen me kërkesa për nevojën e kuadrit të fushës së gjeodezisë dhe sidomos të Inxhinierisë së Gjeodezisë.

2.3.3. Krahasueshmeria ndërkombëtare e programit

Programet e studimit për fushën e gjeodezisë të nivelit baçelor janë të bazuara në vendet e rajonit të Evropës Jug-lindore dhe veçanërisht në Universitetet e Lubjanës, Zagrebit, Tiranës dhe Shkupit.

Duke krahasuar lëndët e përgjithshme sikur janë gjuhët e huaja, programimi, kadastri, metodat e matjes, gjeodezia inxhinierike, rregullim i tokave, hartografia topografike, fotogrametri, pozicionim satelitor, menaxhmenti mund të nxirret një simetri duke vërejt harmonizimin e studimeve të këtij niveli në rajon mirëpo edhe më gjerë në Evropë për shumë nga Universitetet.

2.3.4. Grupi target që i dedikohet programi

Studimet e nivelit baçelor për gjeodezi i ofrohen grupit të kandidatëve të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme dhe të cilët e kanë kaluar me sukses provimin e maturës shtetore.

2.3.5. Orientimi i programit të studimit sipas parimeve udhëheqëse të institucionit (misionit)

Qëllimi kryesor i programit të studimit është të rris ofertën për edukim në Kosovë me shkencën e matjes së tokës. Kjo fushë e studimit është shumë e rëndësishme për vendin, duke marrë parasysh trendet e zhvillimit në inxhinierinë e ndërtimit dhe planifikimit hapësinor. Është e paraparë të ofroj profesionalizëm në tregun e Kosovës dhe të mbështes fushat e tjera të lidhura me tokën.

2.3.6. Qëllimi dhe profili i programit të studimeve

Qëllimi i krijimit të nivelit të studimeve për Baçelor në Gjeodezi, është padyshim krijimi i kuadrit të mjaftueshëm me kompetenca dhe nivel profesional të kënaqshëm si:

- Të nxjerr studente të aftë që të kuptojnë dhe të njohin konceptet e shkencave teknike të gjeodezisë duke përfshirë pjesën teorike që është bazë dhe në pjesën praktike si të domosdoshme në plotësimin e pjesës teorike.
- Të sigurojë për tregun Kosovare dhe me gjerë personel që mund të jenë në rolin e udhëheqesit teknik të kompanive private dhe publike, me elemente bazë punët e gjeodezisë si punë të veçanta apo punë përcjellëse të ndërtimit.
- Të thellojë njohuritë e studimit në disa prej fushave që i ofrohen.
- Të ofrojë zgjidhjen e problemeve të ndryshme në inxhinierinë e Gjeodezisë
- Të sigurojë njohuri për vazhdimin e studimeve apo hulumtimeve shkencore për nivelet e masterit dhe PhD.

2.3.7. Rezultatet e pritura të mësimin

- Të njohë konceptet e shkencave teknike të gjeodezisë
- Të dijë të aplikojë njohuritë teorike në pjesën praktike dhe eksperimentale të ndërtimit
- Të dijë të përdor instrumentet gjeodezike të teknologjisë më të re dhe të i aplikojë në zgjidhjen e problemeve vetanake, shënimeve në kadastrat e Kosovës apo edhe punë të lidhura me ndërtimin.
- Të dijë që me njohuritë e veta të ndihmojë azhurnimin e të dhënve me sistemet aplikative ndërkombëtare, të formojë pikat (koordinatat) shtetërore dhe lokale për aplikim në çështjet pronësore etj.
- Te kete njohuri bazike ne azhurnimin dhe mirembajtje e kadastres se tokave
- Te kete njohuri mbi perdorimin e gjeo informacioneve dhe perdorimin e tyre ne fusha te ndryshme qe lidhen me Token
- Te kete njohuri mbi perdorimin e sistemeve elektronike dhe te GIS-it

2.3.8. Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike/eksperimentale te studimit

Studimet e nivelit të bachelor janë të organizuara në grupin lëndor dhe brenda lëndëve parashihen organizimet e mësimëve në pjesë teorike, numerike, laboratorike dhe praktike. Vlera mesatare e këtyre raporteve të nxjerrura nga lëndët janë: pjesa teorike 30%, pjesa numerike 30%, pjesa laboratorike dhe eksperimentale 40%.

2.3.9. Llogaritja e ECTS-ve

Sipas përcaktimit dhe Statutit të UP-së, për një ECTS llogariten 25 orë mësimi. Shembull i llogaritjes së ECTS përmes formularit për vëllimin dhe sasinë e ngarkesës së studentëve.

Vëllimi dhe sasia e nevojshme e punës (orët për semestër 2+1, 6 ECTS)

Aktiviteti	Orë	Ditë	Javë	Gjithsejt
Ligjerata	2	1	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	1	15	30
Punë praktike				
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1	10	10
Ushtrime në teren				
Kollokfiume,seminare	2	1	10	20
Detyra të shtëpisë	2	1	10	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	3	5	15
Përgaditja përfundimtare për provim	3	5	1	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	4	2	1	8
Projektet, prezentimet, etj	1	3	1	3
Totali				151

Llogaritja: 151 orë/25= 6 ECTS

2.3.10. Puna praktike – internshipi

Fakulteti i Ndertimtarise dhe Arkitekures, dega e studimit të Gjeodezisë ka marrëveshje bashkëpunimi me institucionet qeveritare dhe komunale si dhe me angjencite e pavaruara, përmes të cilave bëhet përzgjedhja e studentëve në grupe për zhvillimin e pjesës praktike të tyre. Pjesa intershp realizohet si pjesë e punimit te diplomës, gjegjesisht ndërlihdjes së pjesës teorike dhe asaj praktike.

Këto marrëveshje të arritura janë:

- Agjencia Kadastrale e Kosovës
- Zyrat Komunale Kadastrale
- Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve
- Geo&Land
- GIZ
- Ministria e Bujqesise, Pylltarise dhe Zhvillimit Rural

2.3.11. Plani i hulumtimeve për programin/ programet ne vlerësim

Duke marre parasysh nivelin Bachelor te studimeve, studenteve u ofrohen mundesi te qasjes neper projekte te ndryshme ne hulumtimin epo analizat e ndryshme ne aspektin profesional. Kjo arrihet perms partnereve te lartecekur, cofte atyre publik apo kompanive private.

2.3.12. Kushtet e regjistrimit dhe pranimit të studentëve

Të gjithë kandidatët i nënshtrohen provimit pranues. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet sipas kriterëve më poshtë:

- Pjesëmarrja e suksesit: max 20 pikë
- Pjesëmarrja e matures: max 50 pikë
- Provimi Pranues: max 30 pikë (provimi pranues mbahet nga Matematika)
- Minimumi per kualifikim 30 % nga pjesa e provimit pranues
- Rangimi deri në numrin e kërkuar sipas konkursit

2.3.13. Pasqyre e programit

Viti I						
Semestri I			Orët/ Java			
Nr.	O/Z	Lënda	L	E	ECTS	Profesori
1	O	Algjeber Lin. dhe Gjeometri analitike	2	2	6	Prof.dr. Fevzi Berisha
2	O	Programim	2	2	6	Prof.asoc.dr. Enver Hamiti
3	O	Fizikë duke përfshirë mekanikën	2	2	6	Prof.dr. Rashit Maliqi (FIEK)
4	O	Teknologjia e bazës së të dhënave	2	2	6	Staf nga UP
5	O	Gjuhë e Huaj	2	0	3	Nedime Belegu
6	O	Ekologji	2	0	3	Sylejman Berisha
Semestri II						
1	O	Gjeometri llogaritëse	2	2	6	Prof.dr. Abdullah Zejnullahu
2	O	Analizë Matematikore	3	3	9	Prof. dr. Fevzi Berisha
3	O	Matje e tokës	2	2	6	Prof.ass.dr. Ismail Kabashi
4	O	Bazat e gjeoinformatikës	2	2	6	Prof.asoc.dr. Përparim Ameti
5	Z	Aplikimi i CAD-it në gjeodezi	2	2	3	Prof.ass.dr. Ismail Kabashi
6	Z	Bazat e Gjeoteknikës	2	1	3	Dr.Sc. Qani Kadiri
Viti II						

Semestri III						
1	O	Bazat e gjeodezisë	3	3	9	Prof.ass.dr. Ismail Kabashi
2	O	Kadastrri	2	2	6	Prof.dr. Murat Meha
3	O	Bazat e gjeodezisë inxhinierike	2	2	6	Prof.ass.dr. Ismail Kabashi
4	O	Metodat e barazimeve	2	2	6	Prof.ass.dr. Murat Meha
5	Z	Hartografi topografike	2	1	3	Prof.ass.dr. Bashkim Idrizi
6	Z	Regjistrimi dhe vlerësimi i patundshmërive	2	2	3	Prof.dr. Murat Meha
Semestri IV						
1	O	Gjeometri diferenciale	2	2	6	Prof.dr. Abdullah Zejnullahu
2	O	Fotogrametri	2	2	6	Prof.asoc.dr. Bashkim Idrizi
3	O	Hartografi	2	2	6	Prof.asoc.dr. Bashkim Idrizi
4	O	Matje në terren, praktikë me instrumente gjeodezike	2	2	6	Prof.asoc.dr. Përparim Ameti
5	Z	Menaxhimi i ujërave	2	1	3	Dr.Sc. Figene Ahmeti
6	Z	Planifikimi hapësinor	2	1	3	IDA Dukagjin Hasimja
7	Z	Studimi i fizibilitetit për GIS	2	1	3	Prof.asoc.dr. Perparim Ameti
Viti III						
Semestri V						
1	O	Pozicionim satelitor	2	2	6	Prof.asoc.dr. Përparim Ameti
2	O	Hulumtimet nga largësitë	2	2	6	Prof.dr. Murat Meha
3	O	Rrjetat gjeodezike	2	2	6	Prof.asoc.dr. Përparim Ameti
4	O	Aplikimi i GIS-it	2	2	6	Prof.asoc.dr. Perparim Ameti
5	Z	Sistemi i informatik i tokës	2	1	3	Prof.dr. Murat Meha
6	Z	Ligjet	2	1	3	Avdulla Alija
7	Z	Aplikimi i GNSS-it në pozicionim dhe navigim	2	2	3	Prof.asoc.dr. Perparim Ameti
Semestri VI						

1	O	Rregullimi i tokave	2	2	6	Prof.asoc.dr. Përparim Ameti
2	O	Menaxhimi i tokës	2	2	6	Prof.dr. Murat Meha
3	O	Punim diplome			9	
4	Z	Etikë profesionale	2	0	3	
5	Z	Menaxhim	2	0	3	
6	Z	Web Hartografi	2	2	3	Prof.ass.dr. Bashkim Idrizi

2.3.14. Përshkrimi i modulit/lëndës

ALGJEBRA LINEARE DHE GJEOMETRI ANALITIKE

Përmbajtja e lëndës: Lënda ka të bëjë me njohuri nga matematika që janë të nevojshme për lehtësimin e fitimit të njohurive nga lëndët tjera dhe zbatimin e njohurive në inxhinierin e gjeodezisë.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimin: Njoftimi me njohuritë nga matematike të nevojshme për aplikimin në shkencën e teorisë së matjeve gjeodezike.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi /lënde mësimore/ studenti do të jetë në gjendje që të përdor dhe të kuptojë drejt nocionet e matematikës së lartë, me qëllim që ato njohuri ti ndihmojnë si aparat ndihmës në lëndët në të cilat është i domosdoshëm përdorimi aparatit matematikor.

Studentët duhet të jenë në gjendje:

- Të zbatojnë bashkësitë numerike në shqyrtimet dhe prezantimin e kuptimeve tjera si nga algebra ashtu edhe nga analiza matematike
- Të njoh kuptimin e matricës dhe përcaktorëve si dhe të vërtetoi vetit e përcaktorëve të cilat zbatohen për zgjidhjen e sistemit të ekuacioneve
- Të zgjidh sistemet e ekuacioneve në forma dhe mënyra të ndryshme
- Të njoh kuptimin e vektorit, veprimet si lineare ashtu edhe jo lineare me vektor si dhe ti zbatoi vetit e veprimeve me vektor në shkencat mekanikës teknike

Forma e mësimdhënies dhe mësim nxënies: (Ligjërata të avancuar, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezantime).

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: kolokiumi i parë 10%; kolokiumi i dytë 10%; detyra të shtëpisë 5%, prezenca 20%, provimi përfundimtar 55%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: projektori, llaptopi, tabela.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
100%	0%

Literatura bazë:

1. Fevzi Berisha-Abdullah Zejnullahu: Matematika- për arkitekturë , 1996, Prishtinë.
2. Fevzi Berisha: Përmbledhje detyrash të provimit nga matematika1,2, Prishtinë 2006.
3. Isak Hoxha – Matematika I,I Ndërtimtari, Prishtinë

PROGRAMIM

Përmbajtja e lëndës: Lënda Programim shpjegon sintaksën e komandave bazike të një gjuhë programuese, si dhe algoritmet e për zgjedhjen e probleme të ndryshme të nivelit shkollorë. Përmbajtja e lëndës përfshin tematikat si të vijim: Llojet e të dhënave, leximi i vlerave hyrëse dhe shtypja e vlerave dalëse, algoritmet për llogaritje të shumës, prodhimin dhe faktorielit, strukturat degëzues (If, Switch), unazat (While, Do While, For), algoritmet për veprim me fusha numerike, përdorimi i fushave (vektorëve dhe matricave) në programim, algoritmet për zgjedhjen e problemeve përmes ndarjes në pjesë më të vogla, ndarja e programit në pjesë (Metodat), teknikat e programimit të orientuar në objekte, klasat, implementimi i funksioneve të mbingarkuara, trashëgimia e klasave dhe përdorimi i stringjeve (vargut të simboleve).

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit: Qëllimi i kësaj lënde është që të pajis studentin me njohuritë bazike në lidhje me teknikat e programimit.

Rezultatet e pritura të nxënies: Theks i veçantë i kushtohet gjuhës programuese Java. Pas mbarimit të kësaj lënde, studenti do të përvetësoj njohuritë vijuese:

- Të kuptoj teorinë prapa programimit
- Të jetë në gjendje të kuptoj dhe përdorë komandat bazë të gjuhës programuese Java
- Të jetë në gjendje të përpiloj algoritmin/diagramin e rrjedhës për zgjedhjen e problemeve të ndryshme të nivelit shkollor
- Të njohë teorinë që qëndrojnë prapa programimit të orientuar në objekte

Forma e mësimdhënies dhe mësim nxënies: Ligjërata të avancuar, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezantime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: kolokiumi i parë 10%; kolokiumi i dytë 10%; detyra të shtëpisë 5%, prezenca 20%, provimi përfundimtar 55%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: projektori, llaptopi, tabela.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
40%	60%

Literatura bazë:

1. Daniel Liang, Introduction to Java Programming, 8th edition, Prentice Hall, 2011,
2. Agni Dika, Algoritmet, 2007
3. Chapman, S.J.: Java for Engineers and Scientists, Printice Hall 2003

FIZIKË DUKE PËRFSHIRË MEKANIKËN

Përmbajtja e lëndës: Fizika dhe matjet. Lëvizja në dy dhe tri dimensione. Ligjet e Njutonit. Puna dhe energjia kinetike. Energjia potenciale dhe ruajtja energjisë. Teoria gravitetit. Lëvizja oshciluese, valët. Vetit e fluideve. Temperatura dhe gazet ideale. Termodinamika. Fusha elektrike. Fusha magnetike. Valet elektromagnetike. Drita, pasqyrat dhe thjerrat. Interferenca, difrakcioni dhe polarizimi dritës. Fizika kuantike.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit:

- Shfrytëzimi i lgjeve fizike për zgjidhjen e problemeve në inxhineri,
- Të i njohohen studentet me konceptet bazike të kinematikës, dinamikës termodinamikës etj,
- Shfrytëzimi ligjeve fizike gjatë modelit dhe zgjidhjes së problemeve konkrete në inxhineri,
- Studentët duhet të kuptoj njohuritë themelore nga fizika në nivelin e përgjithshëm të kulturës inxhinerike,
- Njohjen e e fizikës në nivelin bazik duke aplikuar analizën matematike.

Rezultatet e pritura të nxënies: Për të qenë në gjendje për koherencë mes të madhësive dhe fenomeneve të fizikës dhe të zbatojnë ato gjatë zgjidhjes së problemeve teknike. Për të zhvilluar aftësitë e punës së pavarur dhe të jenë në gjendje për të bërë konkluzionet e duhura. Për të përfunduar matjet praktike në laborator, për të analizuar rezultatet e fituara dhe për të interpretuar ato etj.

Forma e mësimeve dhe mësimeve nxënies: Ligjërata të avancuar, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezantime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: kolokiumi i parë 10%; kolokiumi i dytë 10%; detyra të shtëpisë 5%, prezenca 20%, provimi përfundimtar 55%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: projektori, llaptopi, tabela.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
75%	25%

Literatura bazë:

1. S. Skenderi dhe R. Maliqi, Fizika për studentët e Fakultetve teknike, ligjerata Prishtinë, 2005
2. D. Halliday, R. Resnick, J. Walker, Fundamentals of Physics, John Wiley & Sons, 2001.
3. Russell C. Hibbeler (2012): Engineering Mechanics: Statics (13th Edition)

TEKNOLOGJIA E BAZËS SË TË DHËNAVE

Përmbajtja e lëndës: Definimi i bazës së të dhënave. Të dhënat, informatat, sistemet e informacionit, sistemi organizativ. Modele të dhënave, sistemi i menaxhimit të bazës së të dhënave. Dizajni i bazës së të dhënave: konceptual, dizajni zbatimor dhe fizik. Rrjeti hierarkik, relacional, orientimi objekt. Subjektet dhe mardhënjet. Integriteti i të dhënave. Gjuha programuese SQL. Tipet e bazës së të dhënave SQL. Definimi i i SQL. Manipulimi i bazë së të dhënave SQL.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit: Baza e bazës së të dhënave moderne dhe të dhënat gjeohapsionore. Përfitimi i përdorimit themelor individual me paketa të programeve (softuer) të lirë dhe komercial për bazën e të dhanave (modeli relacional, modeli ER). Të arrihen njohuri për konceptet themelore të bazë së të dhënave të cilat do të bëhen standard industrial në kohën e fillimit të karrierësprofesionale (objekt-relacioni i bazës së të dhënave).

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi studenti duhet të ketë njohuri:

- Teorinë e bazave të të dhënave
- Kupton karakteristikat e bazave të të dhënave; Shqyrton disa më interesante;
- Të definoj terimin sistemi i menaxhimit të bazës së të dhënave (DBMS) si dhe shpjegon funksionet e DBMS
- Kupton bazën e të dhënave SQL

Forma e mësimdhënies dhe mësim nxënies: Ligjërata të avancuar, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezantime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: kolokiumi i parë 10%; kolokiumi i dytë 10%; detyra të shtëpisë 5%, prezenca 20%, provimi përfundimtar 55%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: projektori, llaptopi, tabela.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
60%	40%

Literatura bazë:

1. Galic, Z. (2010): Geoprostorne baze podataka Tehnicka knjiga, Zagreb
2. John W. Foreman (2013): Data Smart: Using Data Science to Transform Information into Insight

GJUHË E HUAJ

Përmbajtja e lëndës: Lënda e gjuhës angleze zhvillon aftësitë e leximit, të folurit, shkrimit dhe të dëgjimit dhe prezanton gramatikën në një mënyrë e cila ofron ushtrime dhe tejkalimin e problemeve të zakonshme në strukturë dhe aplikimin e kohëve. Po ashtu zhvillon dhe pasuron fjalorin teknik profesional të tri drejtimeve të Ndertimtarisë dhe Arkitektuës. Lënda përmban tema të ndryshme nga jeta e përditshme, kultura dhe tekste autentike të cilat kanë për qëllim ngritjen e nivelit të leximit dhe kuptimit të komunikimit gojor dhe me shkrim nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme. prezantime, ese, punime seminarike, fjalori, dëgjimi, diskutimi etj.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit:

- Rrit aftësitë e studentëve në lexim, shkrim, dëgjim dhe komunikim në folur.
- Të rrit aftësinë e komunikimit të studentëve në gjuhën angleze në të folur dhe shkrim.
- Të pasurojnë fjalorin e tyre përmes leximit të pavarur dhe dëgjimit të gjuhës angleze.
- Të fitojnë njohuri në gramatikë duke mësuar dhe praktikuar gramatikën në kontekst.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të mësimit, studenti do të jetë në gjendje:

- Ketë aftësi të të folurit, dëgjuarit. Shkrimit dhe leximit të cilat mundësojnë forma efektive të komunikimit në situata reale të nivelit akademik.
- Të kuptojë terminologjinë teknike si: konstruktiv, gjeodezi dhe hidro.
- Të jepen më të lirë në hartimin e projekteve të ndryshme teknike në gjuhën angleze.

Forma e mësimdhënies dhe mësim nxënies: Ligjërata të avancuar, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezantime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: kolokiumi i parë 10%; kolokiumi i dytë 10%; detyra të shtëpisë 5%, prezenca 20%, provimi përfundimtar 55%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: projektori, llaptopi, tabela.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
50%	50%

Literatura bazë:

1. New Headway Advanced Student's Book (2007). Oxford University Press. Oxford UK.
2. Oxford Dictionary. Oxford University Press. Oxford UK.

EKOLOGJI

Përmbajtja e lëndës: Njohja me aspektet ligjore mjedisore ne Kosove, Regjion dhe BE. Organizimi i Ministrisë së mbrojtjes së mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Kosovë. Gjendja e vetëdijes mjedisore të qytetarit kosovar dhe masat e veprimeve për daljen nga kjo situatë. Analiza e ndotësve të Ajrit në Kosovë dhe detyrimet e operatorëve ndotës. Ndotja e ujit të pijes infrastruktura e nevojshme. Trajtimi i ujërave të ndotura. Ndotja e tokës nga ndotësit e ndryshëm..Sjelljet e qytetareve ngaj Mjedisit jetesor.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit:

- Të fitojnë njohuri të reja të mjaftuara mbi konceptet themelore mbi ndotësit mjedisor.
- Të arrijnë njohuri të kënaqshme, mbi konceptet themelore mjedisore dhe vetëdije të ngritur mbi rrolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit në shoqëri.
- Të arrijnë njohuri themelore për; Ajrin, ndotësit potencial të ajrit në Kosovë, njohje me parametrat ndotës të ajrit.
- Të arrijnë njohuri themelore për ujin e pijes, ndotësit potencial të ujit të pijes në Kosovë, njohje me parametrat ndotës të ujit të pijes. Kujdesin ndaj ujit te pijes.
- Të arrijnë njohuri themelore për; trajtimin e ujërave të ndotura në Kosove, nevoja dhe roli i fabrikave për trajtimin e ujërave në Kosovë.

Forma e mësimdhënies dhe mësim nxënies: Ligjërata të avancuar, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezantime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: kolokiumi i parë 10%; kolokiumi i dytë 10%; detyra të shtëpisë 5%, prezenca 20%, provimi përfundimtar 55%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: projektori, llaptopi, tabela.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
50%	50%

Literatura bazë:

1. Dr.sc. Sylejman Berisha “Ligjerata të përmbledhura dhe të përkthyer “ (Power Point), nxjerr nga ligjëruesit homologë të shteteve të ndryshme,
2. Ligjerata nga homolog ga Westliche Wiliam Univerzitaet- Muenster. Gjermani,
3. “Trajtimi i ujërave të ndotur në lumin, Drini i Bardhë dhe teknologjitë e tajtimit të tyre”. Disertacion.1998. Dr.sc Sylejman Berisha,
4. Ligjërata të shkëputura nga Interneti,prezantime të ndryshme.

GJEOMETRI LLOGARITËSE

Përmbajtja e lëndës: Lënda përmban këto pjesë kryesore: transformimet në rrafsh , koordinatat homogjene dhe transformimet e rrafshit , koordinatat homogjene dhe transformimet e hapësirës.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit: Njoftimi me njohuritë nga gjeometria në formë analitike e pikërisht transformime të ndryshme si dhe koordinata të ndryshme e në veçanti kuaternionet dhe aplikimi i tyre në gjeodezi.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi /lënde mësimore/ studenti do të jetë në gjendje që të përdor dhe të kuptojë drejt nocionet e gjeometrise llogaritese me qëllim që ato njohuri të aplikoj në gjeodezi e pikerish në transformimin e sipërfaqeve të ndryshme si dhe në përpilimin e ndonji softveri për lamin e gjeodezise.

Forma e mësimdhënies dhe mësim nxënies: Ligjërata të avancuar, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezantime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: kolokiumi i parë 10%; kolokiumi i dytë 10%; detyra të shtëpisë 5%, prezenca 20%, provimi përfundimtar 55%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: projektori, llaptopi, tabela.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
50%	50%

Literatura bazë:

1. Duncan Marsh , Applied Geometry for Computer Graphics and CAD,2004, Springer
2. Gerald R. Rising , John A. Graham , John G. Balzano , Janet M.Burt, Alice M. King,, Unified Mathematics , Houghton Mifflin , 1985.

ANALIZË MATEMATIKORE

Përmbajtja e lëndës: Lënda ka të bëjë me njohuri nga matematika që kanë të bëjnë me lehtësimin e fitimit të njohurive nga lëndët tjera dhe zbatimin e njohurive në inxhinieri.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësim: Njoftimi me njohuritë nga matematike të nevojshme për aplikimin në shkencën e gjeodezisë.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi /lënde mësimore/ studenti do të jetë në gjendje që të përdor dhe të kuptojë drejt nocionet e matematikës së lartë, me qëllim që ato njohuri ti ndihmojnë si aparat ndihmës në lëndët në të cilat është i domosdoshëm përdorimi aparatit matematikor.

Studentët duhet të jenë në gjendje:

- të ndërtojë vargje kur janë dhënë kufizat e përgjithshme të tyre
- të zbatoj vetitë e vargut aritmetik dhe gjeometrik në zgjidhjen e problemeve të ndryshme
- të paraqes grafikisht funksionet themelore elementare
- të zbatoj limitin e funksionit për të përcaktuar vazhdueshmërinë e funksionit
- të nxjerr derivatin e funksioneve elementare dhe në bazë të vetive të derivatit të gjejë derivatin e secilit funksion

Forma e mësimdhënies dhe mësim nxënies: (Ligjërata të avancuar, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezantime).

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: kolokiumi i parë 10%; kolokiumi i dytë 10%; detyra të shtëpisë 5%, prezenca 20%, provimi përfundimtar 55%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: projektori, llaptopi, tabela.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
100%	0%

Literatura bazë:

1. Fevzi Berisha-Abdullah Zejnullahu: Matematika- për arkitekturë , 1996, Prishtinë.
2. Fevzi Berisha: Përmbledhje detyrash të provimit nga matematika1,2, Prishtinë 2006.
3. Ismet Dehiri – Matematika I,I Fakultet Teknik, Prishtinë

MATJE E TOKËS

Përmbajtja e lëndës: Lënda fillon me parimet themelore të matjes së tokës, metodat e matjes, sistemin e koordinatave, projeksionin hartografik të Gauss-Kruger, përkufizimin themelor të matjeve GPS, rrejetet poligonale dhe vazhdon me rrejtin e nivelimit dhe përfundom me sipërfaqen referente të lartësive.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit: Merr njohuri teorike dhe praktike në fushën e metodave klasike dhe aktuale të matjeve në terren.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të kësaj lënde, studenti do të ketë njohuri bazike në zgjidhjen e problemeve themelore të gjeodezisë; ka njohuri për metodat themelore të matjes; njeh rrejtin poligonal dhe rrejtin e nivelimit.

Forma e mësimdhënies dhe mësim nxënies: Ligjërata të avancuar, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezantime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: kolokiumi i parë 10%; kolokiumi i dytë 10%; detyra të shtëpisë 5%, prezenca 20%, provimi përfundimtar 55%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: projektori, llaptopi, tabela.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
40%	60%

Literatura bazë:

1. Lu, Zhiping, Qu, Yunying, Qiao, Shubo, GEODESY, 2014
2. Kahmen, H. Vermessungskunde, Berlin, 2005;
3. Bencic, D. Instrumentet per matje dhe sistemet ne gjeodezi dhe gjeoinformatike

BAZAT E GJEONFORMATIKËS

Përmbajtja e lëndës: Matjet relative dhe absolute, projeksionet hartografike, marrëdhëniet hapësinore midis objekteve, sipërfaqet referente, sistemet e koordinatave, transformimet e koordinatave, topologji.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit: Kuptimin themelor të bazës së Gjeoinformatikës dhe Informatikës, rëndësinë e gjeoinformacionit në gjeodezi, aplikimi dhe përdorimi i gjeoinformacionit në gjeodezi, kontributi dhe ndërveprimi i informacionit gjeohapësinor dhe i informatikës në gjeodezi.

Rezultatet e pritura të nxënies: Të zhvillojnë njohuri të thjeshta mbi gjeoinformacionin, të ketë aftësi dhe për të përcaktuar çdo gjeoinformacion të nevojshme në mënyrë korrekte, të përdor informacionin gjeohapësinor për nevojat e gjeodezisë.

Forma e mësimit dhe mësime nxënies: (Ligjërata të avancuar, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezantime).

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: kolokiumi i parë 10%; kolokiumi i dytë 10%; detyra të shtëpisë 5%, prezenca 20%, provimi përfundimtar 55%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: projektori, llaptopi, tabela.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
60%	40%

Literatura bazë:

1. Përparim Ameti, Skripta: Bazat e Gjeoinformacionit
2. GIS, principles and applications Maguire, D.J. et al (1991).
3. GIS – a Computing Perspective, Worboys, M. (2003)

APLIKIMI I CAD-it NË GJEODEZI

Përmbajtja e lëndës: CAD (Ndhmës i vizatimit me kompjuter) është një program fleksibil për dizajnimin, i aplikuar në fusha të ndryshme teknike. Projektimit në fushat inxhinierike është lehtësuar me aplikimin e softuerit CAD, duke bërë të mundur saktësi më të madhe në punë, i lehtë për modifikim të projekteve dhe efikas, sidomos në projektet të cilat kanë bërë përsëritjen e planeve / vizatimeve

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit: Qëllimi kryesor i kësaj lënde, është që të zhvillojë njohuri themelore për detyrat kryesore të gjeodezisë praktike dhe të rrisë njohuritë e studentëve mbi softwerin CAD dhe kryesisht në AutoCad.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të kësaj lënde qëllimi është që studenti të ketë njohuri themelore në lidhje me formën dhe madhësinë e tokës, projeksionet hartografike, llojet e koordinatave dhe transformimin e tyre. Gjithashtu ka për qëllim që studentët në mënyrë të pavarur të mund të zgjidhin detyra të ndryshme nga gjeodezia praktike dhe përmes njohurive të fituara në këtë lëndë, pritet që studentët do të jenë të gatshëm për të krijuar vizatime për qëllime të ndryshme në AutoCad dhe zgjidhjen e detyrave të ndryshme të gjeodezisë.

Forma e mësimdhënies dhe mësim nxënies: (Ligjërata të avancuar, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezantime).

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: kolokiumi i parë 10%; kolokiumi i dytë 10%; detyra të shtëpisë 5%, prezenca 20%, provimi përfundimtar 55%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: projektori, llaptopi, tabela.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
50%	50%

Literatura bazë:

1. Lu, Zhiping, Qu, Yunying, Qiao, Shubo, GEODESY, 2014
2. Kamer N.: Gjeodezia Praktike 1,2 2005, Kosovë
3. Berisha R. (2011), AutoCAD 2010, Prishtinë

BAZAT E GJEOTEKNIKËS

Përmbajtja e lëndës: Hyrje në natyrën dhe origjinën e shkëmbinjëve; domethënia inxhinierike e formave gjeologjike të tokës dhe depozitave të dheut. Sjellja inxhinierike dhe vetitë e dheut, ngjeshja e dheut, përçueshmëria hidraulike, ngjeshmëria dhe rezistenca gërshetuese.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit: Në përfundim të kësaj lënde, studentët duhet të jenë të aftë të:

- Kuptojnë se si janë krijuar dheu dhe shkëmbinjët
- Të klasifikojnë dheun dhe të kuptojnë se si karakteristikat e rëndësishme ndikojnë reagimin e tyre ndaj mbushjes.
- Të planifikojnë kontrollin e kualitetit të ngjeshjes për shtrat të lumit dhe ndërtim të rrugëve.
- Të vlerësojnë vetitë (forcën, ngurtësinë, koeficientin e konsolidimit, përçueshmërinë hidraulike) për përdorim në dizajnin e strukturave gjeoteknike
- Të zgjidhin problem bazike të limitit të rrjedhës së ujërave tokësorë.
- Të zgjidhin probleme me konsolidim një dimensional dhe kompresim.

Forma e mësimdhënies dhe mësim nxënies: (Ligjërata të avancuar, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezantime).

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: kolokiumi i parë 10%; kolokiumi i dytë 10%; detyra të shtëpisë 5%, prezenca 20%, provimi përfundimtar 55%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: projektori, llaptopi, tabela.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
50%	50%

Literatura bazë:

1. Rodrigo Salgado (2008). The Engineering of Foundations, McGraw-Hill.

GJEODEZIA

Përmbajtja e lëndës: Lënda fillon me metodat klasike të përrackimit të koordinatave të pikës, triangulacionin shtetror, metodat e matjes së drejtimeve, gabimet e mundshme të matjeve, vlerësimi i saktësisë së matjes dhe barazimi i matjeve. Lënda përfundon me njohuritë bazë mbi llogaritjet elipsoidale dhe metodat e transformimeve të koordinatave dhe përcaktimin e rrjeta referente gjeodezike.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit: Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që të zhvillojë njohuri themelore për detyrat kryesore të gjeodezisë dhe llogaritjen e sistemeve gjeodezike referente.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të kësaj lënde qëllimi është që studenti të ketë njohuri themelore në lidhje me formën dhe madhësinë e tokës, projeksionet hartografike, llojet e koordinatave dhe transformimin e tyre. Gjithashtu ka për qëllim që studentët në mënyrë të pavarur të mund të zgjidhin detyra të ndryshme nga gjeodezia praktike.

Forma e mësimdhënies dhe mësim nxënies: Ligjërata të avancuar, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezantime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: kolokiumi i parë 10%; kolokiumi i dytë 10%; detyra të shtëpisë 5%, prezenca 20%, provimi përfundimtar 55%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: projektori, llaptopi, tabela.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
50%	50%

Literatura bazë:

1. Wolfgang T.: Geodesy, 3rd Edition, 2001, Berlin, Germany
2. Kamer N.: Gjeodezia Praktike 1, 2005, Kosove
3. Kamer N.: Gjeodezia Praktike 2, 2005, Kosove

KADASTRI

Përmbajtja e lëndës: Baza e regjistrimit të të drejtave për tokën është pjesa individuale e programit mësimor gjeodezike. Kjo ka të bëjë me regjistrimin ligjor të njësive kadastrale në regjistrin kadastral të pronës. Në këtë modul funksion është sqaruar në regjistrimin për të drejtat e pronës. Procesi i regjistrimit të pronës është e sqaruar. Matjet kadastrale dhe perpunimi i tyre. Më pas trajtimi i kursit vazhdon në aspektin ligjor dhe teknik. Marrja e vendimit për regjistrim, vendosjen e tabelës së informacionit dhe regjistrin përfundimtar të pronës në kadastër.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit: Qëllimi i këtij kursi është të pajisë studentët në fushën e gjeodezisë të nivelit bachelor me:

- Informacione teorike epraktike mbi bazën juridike të pronave
- Informacion mbi trajtimin ligjor të pronave për regjistrim në kadastër
- Njohuri praktike për regjistrimin ligjor të pronës në kadastër.
- Njohuri për matjet kadastrale.

Rezultatet e pritura të nxënies: Në përfundim të këtij moduli studenti duhet të jenë në gjendje:

- të kete aftësitë e duhura për përdorimin e sistemit juridik të shtetit
- për të numëruar ligjet për regjistrimin e pronës
- për të bërë krahasimin e sistemeve të regjistrimit të pronës në vend dhe jashtë
- për të përshkruar format ligjore të regjistrimit në njësitë kadastrale.

Forma e mësimdhënies dhe mësim nxënies: Ligjërata të avancuar, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezantime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: kolokiumi i parë 10%; kolokiumi i dytë 10%; detyra të shtëpisë 5%, prezenca 20%, provimi përfundimtar 55%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: projektori, llaptopi, tabela.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
50%	50%

Literatura bazë:

1. Meha, M. Baza juridike e regjistrimit te pronës, dorëshkrim Universiteti i Prishtinës Prishtinë 2007,
2. Meha M, Steiwer.F. Bublaku H. 2011. Procedurat për regjistrimin e pronës dhe shërbimet në kadastër.
3. <http://www.kca-ks.org/>.

BAZAT E GJEODEZISE INXHINIERIKE

Përmbajtja e lëndës: Hyrje në gjeodezi inxhinierike, definicioni dhe roli i saj. Detyrat e gjeodezisë inxhinierike në procesin e projektimit, ndërtimit dhe eksploatimit të objekteve ndërtimore. Elementet e piketimit. Metoda e piketimit të pikës dhe drejtimit. Piketimi horizontal dhe vertikal. Metodat e ndryshme të piketimit të pikave - Piketimi i pikave me metodën polare, ortogonale me prerjen para si dhe analiza e saktësisë. Metoda GPS-RTK. Elementet e trasës në kuptimin vertikal. Drejtimet si elemente të trasës. Kthesat rrethore. Piketimi i lartësive, Piketimi i lartësisë (kuotës) të pikës së projektuar. Llogaritja e masave – vëllimeve. Metoda e profileve tërthore, Rregulla e Simpsonit. Metoda e prizmës. Metoda e izohipseve.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit: Qëllimi i kësaj lënde është që studenti së pari të dijë të bën dallimin në mes të rilevimit dhe piketimit (shënimit apo bartjes).

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti duhet të jetë në gjendje që:

- të dallojë rilevimin nga piketimi,
- të bën piketimin e elementeve të ndryshme gjeodezike (pika, drejtëza, harku rrethor,
- të bën piketimin i lartësisë (kuotës) të pikës së projektuar, piketimi i vijës me ramje të dhënë, piketimi i rrafshit me pjerrësi të dhënë etj.,
- të jap (llogarit) gabimin mesatar të piketimit dhe të bëjë analizën e saktësisë së piketimit, të bën llogaritjen vëllimeve të trupave të ndryshme gjeometrik etj.

Forma e mësimdhënies dhe mësim nxënies: Ligjërata të avancuar, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezantime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: kolokiumi i parë 10%; kolokiumi i dytë 10%; detyra të shtëpisë 5%, prezenca 20%, provimi përfundimtar 55%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: projektori, llaptopi, tabela.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
50%	50%

Literatura bazë:

1. Kabashi, I. (2008): Gjeodezia Inxhinierike I. Dispencë, FNA-Prishtinë,
2. Uren, J. Price, W. F. (1992): Surveying for Engineers. MacMillan Press Ltd, London,
3. Müller, G. (2002): Handbuch Ingenieurgeodäsie 2., völlig neu bearb. unterw. Aufl., VEB Verlag für Bauwesen, Berlin,

METODAT E BARAZIMIT

Përmbajtja e lëndës: Teoria e gabimeve është i njohur mirë nga Gausit dhe autorë të tjerë. Teoria e rregullimit do të bëjë balancë mes punëve praktike nga matjet gjeodezike dhe trajtimet e tyre matematikore nëpërmjet modelit matematik. Për të siguruar metodat rregulluese klasike ka për t'u integruar në zhvillimet e reja teknologjike në fusha të anketimit.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit: Ky kurs fokusohet në metodologjitë dhe metodat e rregullimeve matjet gjeodezike për njohuritë bazë. Theks i veçantë do të vendoset në përdorimin e teknikave të reja të një design model të sistemit të rregullimit.

Rezultatet e pritura të nxënies:

- Studenti ka për të përshkruar metodat e rregullimeve të një matje gjeodezike
- Studenti ka për të kuptuar dhe interpretuar teorin themelore të probabilitetit,
- Studenti duhet të klasifikojë matjet para fillimit barazimit;
- Studenti të kuptoj formën e barazimeve për matje të dyfishta,
- Studenti duhet të përshkruaj procesin e barazimeve të matjeve të drejtpërdrejta,
- Studenti ka nevojë për të përcaktuar dhe sqaruar funksionin e barazimeve,

Forma e mësimdhënies dhe mësim nxënies: (Ligjërata të avancuar, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezantime).

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: kolokiumi i parë 10%; kolokiumi i dytë 10%; detyra të shtëpisë 5%, prezenca 20%, provimi përfundimtar 55%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: projektori, llaptopi, tabela.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
50%	50%

Literatura bazë:

1. Meha, M. 2011. Barazimi i matjeve gjeodezike. Dorshkrim nga ligjeratat. UP. Prishtinë
2. Nela, K. 2009. Teoria e Gabimeve, UP, Prishtinë.
3. Huaan, F. 2010. Theory of Errors and Least Squares Adjustment 100 44 Stockholm, Sweden, August 2010

HARTOGRAFIA TOPOGRAFIKE

Përmbajtja e lëndës: Lënda fillon me përkufizimin, karakteristikat, klasifikimin dhe rëndësinë e hartave topografike, më pas jepen mënyrat e ndryshme të formimit të emërtimeve dhe nomenklaturës së hartave topografike sipas standardeve ndërkombëtare dhe atyre të hartave topografike të Kosovës, që të vazhdojë me sqarim të detajuar të përmbajtjes së hartave topografike të shkallë 1:25000 deri në 1:200000.

Në vazhdim paraqiten metodat dhe teknologjia e përpilimit të hartave topografike, shoqëruar me të gjitha standardet që duhet ti përmbajnë hartat topografike, deri te krijimi i origjinalit botues dhe kontrollit të kualitetit të hartave.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit: Mes kësaj lënde u mundësohet studentëve të përfitojnë njohuri themelore teorike dhe praktike për hartografinë topografike si disiplinë shkencore dhe hartat topografike, edhe atë duke filluar që nga përkufizimi, karakteristikat, rëndësia, nomenklatura dhe emërtimi i hartave topografike.

Rezultatet e pritura të nxënies:

- Shpjegimi i procesit të kolektimit të të dhënave hyrëse.
- Shpjegimi i fazave mbi përpilimin e hartës
- Definimi i elementeve matematike të hartës.
- Kontroll të kualitetit të hartave topografike.
- Njohja e standardeve të modelimit të hartave topografike.
- Aplikon metodat automatike për përpilimin e hartave topografike.

Forma e mësimdhënies dhe mësim nxënies: Ligjëratat me prezantim dhe demonstrime praktike të hartave, ushtrimet numerike, seminar semestral me detyra konkrete, përpilim të hartës topografike si punim individual semestral, diskutime gjatë ligjëratave, ushtrime në grupe

